

Numri i lëndës: 2022:129601

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05475046

C.nr.398/2022

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NËV.** Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtorin profesional Agon Halabaku, në çështjen kontestimore të paditëses B.I.nga R. i V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson H.H., avokat nëV., kundër të paditurës Komuna eV. – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i orëve shtesë, me vlerë të kontestit 1,920 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 18.03.2024, nxjerr këtë:

### A K T G J Y K I M

**I. MIRATOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.I.nga R. iV., DETYROHET e paditura Komuna eV. – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të 200 orëve të mbajtura shtesë, për vitet shkollore 2018/19, 2020/21 dhe 2021/22, t’ia paguaj shumën prej 1,200 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 23.06.2022, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**II. Refuzohet** e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, e kërkuar në emër të kompensimit për orët mësimore shtesë, për vitet shkollore 2015/16, 2016/17 dhe 2017/18, për gjithsej 120 orë, në shumë të përgjithshme prej 720 euro.

**III.** DETYROHET e paditura që t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës paditëses B.I. në shumë prej 135 euro, të llogaritura 104 euro, për përpilimin e padisë dhe 31 euro, për taksë gjyqësore, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

### A r s y e t i m

Paditësja B.I. nga R. iV., përmes të autorizuarit të saj avokatit Hajriz Lubishtani, më datë 23.06.2022, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës Komuna eV., me objekt kontesti kompensimi i orëve shtesë, me vlerë të kontestit prej 1920 euro.

Në padi ka theksuar se paditësja është e punësuar te e paditura, në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Safet Rexhepi” në Zhiti, paralelja e ndarë fizike në fshatin Ballancë dhe SH.F.M.U. “Skender Emërllahu” në Ramjan, në cilësinë e mësimitdhënëses ku edhe vazhdon të jetë në këtë pozitë të punës.

Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (në vijim: KKAK) të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, paditëses i takon kompensimi për orët shtesë. Gjykatës i ka propozuar të miratojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, ashtu që paditëses t’ia kompensojë orët shtesë të mbajtura

jashtë kontratës së punës me kohë të pacaktuar si mësimdhënëse. Ajo ka kërkuar kompensimin për orët shtesë të mbajtura gjatë viteve shkollore 2015/16, 2016/17, 2017/18, 2018/19, 2019/20, 2020/21 dhe 2021/22, për gjithsej 320 orë, duke e llogaritur secilën orë nga 6 €, në shumë të përgjithshme prej 1,920 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 135 euro.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditëses të pabazuar, duke arsyetuar se e njëjta nuk është palë dhe nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, meqë kjo kontratë është nënshkruar nga MASHT-i, në njërin anë dhe SBASHK-u, në anën tjetër, prandaj nuk prodhon efekt juridik për të paditurën. Ka konsideruar se kërkesa e paditëses është e vjetruar në bazë të nenit 78.1 dhe 82 të Ligjit të Punës, meqë paditësja nuk kanë adresuar dhe nuk i ka shtjerrë mjetet juridike në procedurë administrative për këtë çështje kontestuese. Ka theksuar se më datë 22.11.2021 MASHT ka bërë shkëputjen e kontratës, prandaj në momentin e ushtrimit të padisë e njëjta nuk është në fuqi. Sa i përket kërkesës për kompensim të orëve shtesë, ka theksuar se një e drejtë e tillë nuk i takon pasi me asnjë dispozitë ligjore nuk përcaktohet kjo pagesë. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja B.I. është e punësuar te e paditura dhe për periudhën 22 Shtator 2014 dhe vazhdon të punoj ende, ndërsa për vitet shkollore 2015/16 ka mbajtur orët mësimore shtesë mbi normën e punës gjithsej 40 orë, përV.n shkollor 2016/17, 40 orë shtesë, 2017/18, 80 orë shtesë, përV.n shkollor 2018/19, 80 orë shtesë, përV.n 2020/21, ka mbajtur 40 orë, ndërsa përV.n shkollor 2021/22, ka mbajtur 40 orë, apo gjithsej 320 orë shtesë. Këto fakte i vërteton Vërtetimi me nr. protokollin 185/1, i lëshuar me datë 14.08.2023, nga SH.F.M.U. “Safet Rexhepi” në Zhiti.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritore, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe jo themelësia e kërkesëpadisë e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila

përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive” lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 4 se “Kur mësimdhënësit dhe punonjësit e tjerë arsimor kryejnë orë mësimi mbi ngarkesën mësimore mujore të parashikuar me këtë kontratë, orët mbi normë i paguhen sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi (si orë të rregullta).

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit përV.n 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe përV.n 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga të theksuarat më lartë, gjykata vendosi t’ia aprovojë pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditëses si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se të njëjtës i takon kompensimi i orëve të mbajtura shtesë – mbinormën e tyre për të zëvendësuar kolegen gjykata ia njohu si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe lartësinë ia vërtetoi bazuar në nenin 35.4 të KKAK-së, duke i llogaritur si orë të rregullta, e që në fakt lartësia e kërkesëpadisë as nuk ishte kontestuese për të paditurën, pasi e njëjta kontestoi vetëm bazën e kërkesëpadisë. Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se kërkesa e paditëses për kompensimin e orëve shtesë për periudhën kohore, respektivisht për vitet shkollore 2015/16, 2016/17 dhe 2017/18, për gjithsej 120 orë, në shumë të përgjithshme prej 720 euro, është e parashkruar, ashtu siç ishte thirr edhe e paditura me rastin e dhënies së përgjigjes në padi. Pra kontestimi i kërkesëpadisë së paditëses në aspektin kohor (për shkak të parashkrimit të kërkesës) nga e paditura, rezulton të jetë pjesërisht i saktë dhe i bazuar në ligj, për faktin se me nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212, Ligji i Punës, kur flitet për afatin e parashkrimit thuhet citojmë: “ *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”.

Duke qenë se paditësi ka ushtruar (kërkesë) padi me datë 23.06.2022, për kompensim në para, për vitet shkollore 2015/16, 2016/17, 2017/18, 2018/19, 2019/20, 2020/21 dhe 2021/22, konstatohet se kërkesëpadia e saj është parashkruar pjesërisht, pasi që kërkohet kompensimi pas 6 viteve, ku si e tillë nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, andaj gjykata pretendimin e palës së paditur të dhënë në përgjigje në padi, se kërkesa e paditëses është parashkruar, e vlerëson pjesërisht si të drejtë dhe të bazuar në ligj, neni 87 i Ligjit të Punës, ku me këtë rast gjykata ia ka refuzuar kërkesën paditëses për vitet si në pikën II, të dispozitivit.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi se KKAK nuk prodhon efekt juridik për të paditurën, gjykata e vlerëson të pabazuar, pasi e njëjta është e lidhur në nivel vendi

dhe bazuar në nenin 2 të saj është e zbatueshme për të gjithë të punësuarit dhe punëdhënësit, që përfshin këtu edhe të paditurën. Nga kjo, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të cilat derivojnë nga Kontrata Kolektive. E drejta e punës si kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare e me ligj, për kërkesat në të holla që rrjedhin nga marrëdhënia e punës nuk është e nevojshme që paraprakisht i punësuarit t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, ndërsa edhe pse paraprakisht paditësja iu ishte drejtuar me kërkesë të paditurës që në procedurë administrative të kompromsohet për orët shtesë të mbajtura. Fakti se nga kontrata e V.t 2021 është shkëputur MASHT, gjykata vlerëson se nuk është fakt relevant për këtë çështje kontestuese, pasi të njëjtat kontrata prodhojnë efekt juridik deri në momentin e shkëputjes dhe shkëputja nuk ka fuqi retroaktive, ashtu që kërkesat e palëve zbatohen për atë sa kërkohen kur kontratat kanë qenë në fuqi. Për më tepër, pretendimi se paditësja nuk i takon e drejta të kompensohen për orët e mbajtura shtesë, gjykata e gjeti të pabazuar edhe nga neni 56.1 i Ligjit të Punës që përcakton se “Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuarit ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës”.

Gjykata vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësja në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NËV.

C.nr.398/22, datë 18.03.2024

G j y q t a r i

Raif Fazliu

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.

